



Policia jep më shumë detaje rreth vrasjes në Baks të Skenderajt

KRONIKA | July 23, 2022 - 23:07

SHPËRNDAJE:  

Policia e Kosovës ka dhënë më shumë detaje me ngjarjen e sotme në Baks të Skenderajt, ku një përleshje ka përfunduar me përdorimin e armëve të zjarrit, ku si pasojë e kësaj përleshje, një person ka humbur jetën dhe dytë tjerë janë plagosur.

Sipas njoftimit të PK-së thuhet se “sot më, 23 Korrik 2022, policia në Skenderaj ka pranuar informatën për të shtëna me armë zjarri në fshatin Baks të Skenderajt”, raporton Zeri.info.

Me të pranuar informacionin, në vendin e ngjarjes me urgjencë kanë dalë të gjitha njësitet kompetente policore.

“Nga informatat e para nga vendi i ngjarjes është kuptuar se në rast ishin përfshirë disa persona, ku si pasojë e të shtënave me armë zjarri tre persona ishin të plagosur. Dy persona ishin dërguar për tretman mjekësor në QKMF-Skenderaj, ku njëri prej tyre si pasojë e plagëve nga arma e zjarrit kishte humbur jetën dhe mjeku kujdestar ka konfirmuar vdekjen e tij, ndërsa i plagosuri tjetër është transferuar për tretman mjekësor në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) në Prishtinë”, thuhet në njoftimin e Policisë.


“Ndërkohë policia është njoftuar se një person tjetër kishte kërkuar tretman mjekësor në QKMF në Drenas dhe pas trajtimit fillestar mjekësor, në shoqërim të policisë është dërguar për trajtim të mëtutjeshëm në SHSKUK dhe është nën përcjelljen e policisë pasi që sipas informatave fillestare mund të jetë i dyshuar potencial në këtë rast”.

“Gjithashtu është arrestuar edhe një person tjetër dhe do të intervistohet në cilësinë e personit të dyshuar për përfshirjen në këtë rast”.

Tutje thuhet se “Njësia e hetimeve Rajonale ka kryer bastisje në dy lokacione dhe ka sekuestruar dy armë: një armë automatike AK-47 dhe një pushkë gjuetie”.


“Njësia e Hetimeve Rajonale së bashku me prokurorin e shtetit janë në vendin e ngjarjes ku është duke u bërë ekzaminimi i vendit të ngjarjes dhe do të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për zbardhjen e plotë të rrethanave të këtij rasti”, thuhet në njoftim./Zëri

Të rekomanduara



Të shtëna armësh në aheng, policia arreston...

July 25, 2022



Hajnat i vjedhin gjëra nga vetura një...

July 25, 2022

Babai shqiptar i 10 fëmijëve në Austri tenoti ta vrasë gruan me kablo elektrike

KRONIKA | July 24, 2022

Alarm i rremë për bombë në Universitetin e Prishtinës

KRONIKA | July 24, 2022

Alarm për bombë në Amfiteatrin e Bibliotekës Universitare në Prishtinë

KRONIKA | July 24, 2022

Policia sllovene: 27-vjeçari nga Kosova u mbyt në liqen, s'bëhet fjalë për krim

KRONIKA | July 24, 2022

Shoferi i dehur shkakton aksident në Zubin Potok, vdes një 23-vjeçar

KRONIKA | July 24, 2022

Arrestohet një person në Vushtri për zjarrvënje të qëllimshme

KRONIKA | July 21, 2022

Më të lexuarat



KRONIKA | July 24, 2022

Publikohet fotografia e mërgimtarit që u vra në Skënderaj



KRONIKA | July 23, 2022

Arrestohet ferizajasi që mbajti tri ditë të mbyllur të dashurën, e rrahu dhe e bëri për spital



KRONIKA | July 23, 2022

Një i vranë dhe dy të plagosur në Baks të Skenderajt



KRONIKA | July 23, 2022

Gjendet i vdekur një person në Prishtinë



KRONIKA | July 23, 2022

Policia jep më shumë detaje rreth vrasjes në Baks të Skenderajt



KRONIKA | July 24, 2022

Babai shqiptar i 10 fëmijëve në Austri, tenoti ta vrasë gruan me kablo elektrike